

# Bëhemi prindër kujdestarë

Kjo broshurë është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërgjegjësimi dhe forcimi i kapaciteteve në shërbimin social alternativ” pjesë e skemës së sub-granteve mbi “Zhvillimi i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për Familjet Kujdestare në Shqipëri” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në partneritet me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi e Qendres për Adminsitrim Social Ekonomik Territorial dhe këndvështrimet e autorëve jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) apo të SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Tiranë, Nëntor 2019

## Përmbajtja

Hyrje

Çfarë është familja kujdestare?

Kush janë fëmijët

Kërkesat

A jam gati?

Hapat



## Hyrje

Në shoqërinë e sotme, në kategorinë e fëmijëve pa përkujdesje prindërore përfshihen fëmijë të mbetur jetimë biologjikë, si dhe fëmijë nga familje me probleme sociale, psikologjike dhe ekonomike. Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore po rritet për shkak të rritjes së shkurorëzimeve, aksidenteve, braktisjes së fëmijës për shkak të lidhjeve të paqëndrueshme, emigracionit, problemeve shëndetësore, situatave të vështira ekonomike, etj.

Kryesisht institucionet rezidenciale janë ata që adresojnë problemet e braktisjes së fëmijëve dhe nevojat e tyre për kujdes deri në moshën kur kalon faza e fëmijërisë dhe konsiderohet se është rritur sipas legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Këto institucione nuk arrijnë të ofrojnë kujdes, dashuri dhe vëmendje individuale që fëmija merr në familje. Ky fenomen njihet si dëmtim institucional, veçanërisht kur fëmija qëndron për një kohë të gjatë në institucione dhe manifestohet me sjellje devijante, agresivitet ose vonesë në zhvillimin psikologjik dhe emocional të fëmijëve dhe aftësive të integritimit shoqëror. Institucionalizimi i fëmijëve nuk i siguron fëmijës cilësinë e jetës dhe nevojën për të qenë të shëndetshëm dhe të lumtur.

Kujdesi i fëmijëve në familjet kujdestare siguron vazhdimësinë e familjes dhe i ndihmon ata të bëjnë lidhjet midis së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Ne besojmë se çdo fëmijë ka të drejtë të ketë një familje të sigurt, të qëndrueshme dhe të kujdesshme. Zhvillimi i shëndetshëm i një fëmije realizohet më mirë në një mjedis të ngrohtë familjar

Kolegia ime sot përfundoi procedurat për kujdestari. Ishte shumë e lumtur që në shtëpinë e saj të priste fëmijën e tretë.

### **Çfarë është familja kujdestare?**

Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykatata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale. Kujdestaria në familje është një formë e përkujdesit alternative për fëmijë të cilët ndodhen jashtë kujdesit të familjeve të tyre.

### **Kolegia jote e nje fëmijën? Ka lidhje gjaku?**

Në fakt jo. Ajo është duke u bërë një prind kujdestar pa lidhje gjaku. Fëmija që ajo po merr nuk ka lidhje ose mardhënie të mëparshme me të. Por në fakt ka dhe një formë të tillë kujdestarie me lidhje gjaku ku të afërm të fëmijës marrin kujdestarinë për shkaqe të ndryshme.

### **Do me thënë kolegia jote ka birësuar fëmijën?**

Jo. Nuk e ka birësuar. Birësimi është një proces tjetër i ndryshëm nga kujdestaria. Qëndrimi i fëmijës në familje kujdestare është i përkohshëm, deri në momentin që familja biologjike fuqizohet dhe më pas fëmija rikthehet në familjen e saj biologjike.



### **Për sa kohë mund të qëndrojë fëmija tek unë?**

Për aq kohë sa familja biologjike të mund të fuqizohet. Mund të jetë për disa muaj, por edhe për disa vite. deri në moshën 18 vjeç mund ta mbash fëmijën.

Qëndrimi kushtëzohet nga specifikat dhe nevojat e fëmijës rast pas rasti dhe familjes biologjike.

### **Nuk kisha dëgjuar më parë për këtë procedurë. Jam kurioz të di: kush fëmijë merren në kujdestari?**

Merren në kujdestari ata fëmijë që në familjen e tyre biologjike kanë problem ekonomike, shëndetësore ose sociale. Mund të merren në kujdestari edhe fëmijët e braktisur ose të lindur jashtë martese. Gjithashtu edhe fëmijët e një të afërmi të cilët kanë vështësi për ta mbajtur fëmijën. Kështu që mos lërë një fëmijë të shkjo në institucion por bëhu ti familja kujdestare.

### **Po ne a mund të marrim në kujdestari një fëmijë? Tani Ana ka shkuar 9 vjeç kurse Agimi është 5 vjeç. Po sikur të marrim edhe ne një fëmijë në kujdestari? Mundësi ekonomike kemi. Si mendon?**

Duhet ta diskutojmë bashkë edhe me fëmijët. Është një proces i gjatë me disa hapa që duhet të ndjekim. Por është e rëndësishme që edhe fëmijët tanë ta duan po aq sa ne një fëmijë në kujdestari. Është e rëndësishme që ai fëmijë të ndihet mirë dhe



ngrohtë me të gjithë kur të vijë në familjen tonë. Por nuk jam shumë e sigurt për kriteret që duhet të plotësojmë. Ndoshta mund t'ë kemi pak më shumë informacion. Po telefonoj kolegen time.

Alo. Përshëndetje Ema! Së pari përgëzime edhe një herë për vendimin për t'u bërë prind kujdestar. Jam duke e diskutuar me bashkëshortin por nuk kemi shumë informacion dhe doja të të pyesja se cilat janë kriteret për të qënë familje kujdestare?

Faleminderit, jam shumë e emocionuar dhe mezi po pres të takoj fëmijën. Të gjithë në familje jemi shumë të lumtur në fakt. Vajza e ka bërë gati dhe dhomën për ta mirpritur motrën.

Në lidhje me kriteret janë disa të cilat po i rendis por jo nga rëndësia:

1. Të gjithë anëtarët e familjes duhet të kenë interes dhe të jenë të motivuar për të qënë familje kujdestare;
2. Sigurisht ju nuk duhet të keni qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;
3. Duhet të jeni të aftë për të kryer detyrën e kujdestarit;
4. Familja duhet të vërtetojë me raport mjekoligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;



1. Të strehoni dhe të garantoni një mjedis familjar të sigurtë për fëmijën. Nuk duhet të keni qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve apo fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;
2. Duhet të respektoni ushtrimin e besimit fetar të fëmijës;
3. Duhet të jeni të gatshëm të zbatoni parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
4. Është e rëndësishme të jeni të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;
5. Që të bëheni prindër kujdestarë nuk duhet ta keni humbur ose nuk u është hequr përgjegjësia prindërore;
6. Ligji kërkon që prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç dhe të ushtroni përgjegjësi prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

#### **Dhe ku duhet të drejtohem për t'u bërë familje kujdestare?**

Sigurisht që pranë Bashkisë ku ju jetoni. Në rastin tuaj ju jetoni në Bashkinë Tiranë kështu që drejtohuni pranë strukturave të shërbimit social dhe duhet që të plotësoni një kërkesë të cilën jua jep punonjësi i bashkisë për ta plotësuar.

Më pas ju do të ndiqni takime informimi mbi kujdestarinë. Do ju japin shumë informacione të



hollësishme mbi përgjegjësitë, të drejtat si dhe detyrimet tuaja si familje kujdestare.

Pas kësaj ju do të intervistoheni nga punonjësi social për të parë nëse pavarësisht dëshirës dhe interesit tuaj ju kenë kushte dhe mundësi të përshtatshme për mirë rritjen e fëmijës.

Do ju kërkohet të dorëzoni disa dokumente plotësuese të tilla si:

- a) Raport mjeko- ligjor që vërteton se ju jeni të aftë fizikisht dhe mendërisht;
- b) Referenca për familjen tuaj nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja.

Vetëm këto dokumenta dorëzohen për t'u bërë familje kujdestare?

**Sigurisht që jo. Punonjësi social mbledh informacion dhe siguron dokumenta të tjera të tilla si:**

1. Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
2. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;
3. Të ardhurat e familjes;
4. Pasuritë e paluajtshme të familjes;



5. Vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme me komunitetin;
6. Verifikimin social-ekonomik i familjes nga administrator shoqëror i njësisë administrative.

Të falenderoj Ema. Për të gjithë informacionin e detajuar. Jemi shumë të interesuar për të qënë familje kujdestare potenciale, dëshirojmë shumë të marrim një fëmijë të tretë.

Sa mirë. Do ju përkrahja shumë në këtë iniciativë. Ju do të hapni zemrën dhe shtëpinë tuaj për një fëmijë që ka shumë nevojë për ju!

Faleminderit Ema për gjithë informacionin e hollësishëm. Edhe një pyetje të fundit, a ofron mbështetje financiare Bashkia?

Po, Bashkia ofron 9000 lekë në muaj për ushqyerjen e fëmijës së vendosur në kujdestari, kurse për fëmijët me aftësi të kufizuar është 10000 lekë në muaj. Masa e financimit për familjen kujdestare për një fëmijë të vendosur në kujdestari është:

**Shpenzime për veshmbathje 10 000 lekë në vit;**  
**Shpenzime për shkollim 5 000 lekë në vit;**  
**Shpenzime të tjera 10 000 lekë në vit.**



Tashmë kam një informacion më të detajuar kështu që duhet të flas edhe me fëmijët dhe të vendosim së bashku të marrim në kujdestari një fëmijë apo jo!

Besoj se edhe ata do të kenë dëshirën të mirëpresin në shtëpinë tonë dhe të kujdesen për një fëmijë që mund të ketë shumë nevojë për ne të gjithë. Në fakt, është një veprim human shumë i bukur por që duhet ta vendosim të gjithë së bashku për të marrë iniciativën.



**Për më tepër informacion na kontaktoni:**

**SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri**

Rruga “Qemal Stafa” Pallati 1, Ap.15; P.O Box 1524, Tirana, Albania

Telefon: +355 44 536901 . E-mail: [info@soskd.org.al](mailto:info@soskd.org.al)

**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**

Bulevardi “Bajram Curri”, Pallatet Agimi, Shk.18 Ap 322,

Tirane, Albania

Telefon: +355 4 2253113 . E-mail: [tlas@tlas.org](mailto:tlas@tlas.org)

**Bashkia Tiranë**

Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Telefon: 0800 0888 E-mail: [info@tirana.al](mailto:info@tirana.al)

**Qendra ASET**

Rruga “Bardhyl”, Pallatet Bifter & Co, Kati 2, Ap 2

E-mail: [info@asetcenter.al](mailto:info@asetcenter.al)

